



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË ADMINISTRIMIT TË BIZNESIT-KUMANOVË

Kumanovë, 2021

**Fakulteti i Administrimit të Biznesit-Факултет за бизнис администрација-Faculty of Business
Administration**

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: ba@unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I EVALUIMIT	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT	3
2.1. Historiku	3
2.2. Plani strategjik	4
3. STRUKTURA E FAKULTETIT	6
3.1. Organogrami	6
4. VEPRIMTARIA MËSIMORE	7
4.1. Struktura e kuadrit mësimor	7
5. STRUKTURA E STUDENTËVE	7
5.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	7
5.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master)	8
6. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE	10
7. REALIZIMI I ORËS MËSIMORE NË KUADËR TË FAKULTETIT	12
7.1. Anketimi i studentëve	12
8. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE	14
9. SWOT ANALIZA	15
10. KONKLUZIONI	17

1. QËLLIMI I EVALUIMIT

Procesi i evaluimit të brendshëm si qëllim kryesor ka vlerësimin e kualitetit të procesit mësimor/shkencor në bazë të komponentëve më të rëndësishëm, siç janë: programet studimore, kuadri mësimor/shkencor, veprimtaria mësimore/shkencore, studentët, resurset materiale dhe hapësinore si dhe detektimi i anëve të forta dhe mangësive në procesin mësimor, me qëllim që po të njëjtët të përmirësohen ose të zhvillohen. Procesi i evaluimit paraqet një bazë për përcaktimin e pozitës së Fakultetit të Administrimit të Biznesit në sistemin e përgjithshëm arsimor dhe si rrjedhojë përmes këtij procesi të rritet konkurrenca dhe efikasiteti i tij si dhe t'u ofrohen studentëve programe studimore në përputhje me programet e fakulteteve të ngjashme në rajon dhe më gjerë.

Raporti i vetevaluimit për Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë përfshin këta komponentë:

- Përshkrimi i Fakultetit (historiku);
- Struktura e Fakultetit;
- Veprimtaria mësimore;
- Struktura e Kuadrit mësimor - shkencor;
- Struktura e studentëve në studimet deridiplomike;
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte;
- Rezultatet e evaluimit të orës mësimore;
- SWOT analiza dhe konkluzioni

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Universiteti i Tetovës në kontinuitet ka shënuar të arritura të mëdha në të gjitha drejtimet në procesin mësimor - shkencor. Ai është ngritur tashmë në një institucion arsimor dhe shkencor me përmasa kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare duke tërhequr kah vetja profesoratin më të mirë të vendit dhe të rajonit, figurat më eminente të arsimit, shkencës dhe

3

Fakulteti i Administrimit të Biznesit-Факултет за бизнис администрација-Faculty of Business Administration

kulturës shqiptare në përgjithësi, me një infrastrukturë dhe nivel të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe me avantazhe në raport me konkurrencën.

Fakulteti i Administrimit të Biznesit në Kumanovë, si pjesë e Universitetit të Tetovës u themelua më datë 22.11.2008, si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, e shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike dhe të gjithë dashamirësve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë.

Sot avantazhet tona qëndrojnë në infrastrukturën që e përbëhet nga sallat, laboratorët, amfiteatrot, programet studimore bashkëkohore, të gjitha në funksion të kërkesave të tregut dhe stafin akademik të kualifikuar që përdor literaturën më bashkëkohore.

Fakulteti Administrimit të Biznesit në Kumanovë aktualisht është i organizuar në 2 programe studimore:

Cikli i parë:

- Administrim Biznesi (240 ECTS)
- Administratë Publike (240 ECTS)

Cikli i dytë:

- Administrim Biznesi (60 ECTS)
- Administratë Publike (60 ECTS)

Këto programe studimore janë të organizuara sipas standardeve më bashkëkohore, Procesit të Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) të organizuara me akreditimin 4+1.

2.2. Plani strategjik

Plani strategjik paraqet një strukturë ku ndërthehen një sërë aktivitetesh që do të ndërmerren në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë në planin afatmesëm dhe afatgjatë, në përputhshmëri me perspektivat vizionare dhe misionin që duhet realizuar për të arritur qëllimet e institucionit tonë.

Në pika më të shkurtra paraqesim këtë strukturë aktivitetesh si më poshtë:

- Realizim i programeve studimore konform Ligjit për arsim të lartë dhe kërkesave të tregut, bazuar në bashkëpunimin me komunitetin e bizneseve;
- Përkujdesje maksimale në avancimin e stafit akademik me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kyçjes së tyre në hulumtime shkencore nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe publikime të punimeve cilësore në revista prestigjioze të ranguara në rrafshin ndërkombëtar;
- Është paraparë që të jemi pjesë e komunikimit, detektimit dhe ofrimit të zgjidhjeve rreth problematikave ekonomike që do të paraqiten në periudhën vijuese. Këto aktivitete planifikohen të realizohen përmes seminareve, debateve shkencore dhe profesionale, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktiviteteve të ngjashme;
- Stimulimi nëpërmjet motivimit si dhe kultivimi i arritjeve akademike, mësimore dhe shkencore të stafit dhe studentëve;
- Rritje të nivelit të informimit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ përmes implementimit të ERP sistemeve, forcim të bashkëpunimit me studentët dhe bizneset përmes Qendrës për Karrierë dhe rritje të mundësive për kyçjen e studentëve në tregun e punës;
- Evaluimi i vazhdueshëm i procesit mësimor, realizimi i kurrikulave dhe qëllimeve të programit studimor;
- Mbështetje e studentëve me sukses të dalluar, për mobilitet konform rregullave që parashih Sistemi i Bolonjës i aplikuar në procesin mësimor tek institucioni ynë dhe mundësi për punësim të tyre.

Fakulteti i Administrimit të Biznesit përmes programeve studimore që ofron, synon realizimin e qëllimeve në vijim:

- Përgatitja e studentëve për ndërtim karriere në sektorin publik, joqeveritar dhe atë privat;
- Zhvillimi i kompetencave dhe aftësive menaxheriale në institucionet publike, hulumtuese, analizimi i politikave publike, menaxhimi me resurset njerëzore dhe organizatat jofitimprurëse.

3. STRUKTURA E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Fakulteti i Administrimit të Biznesit në Kumanovë veprimtarinë e vet e bazon në Ligjin për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në kuadër të tij ekzistojnë organet përkatëse të parapara me Ligjin për arsim të lartë, siç janë:

- Këshilli mësimor - shkencor, i cili përbëhet nga profesorë të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore dhe përfaqësues të studentëve;
- Dekani;
- Prodekanët;
- Sekretari;
- Shefat e programeve studimore;
- Administrata dhe
- Shërbimi teknik.

Këshillin mësimor - shkencor të Administrimit të Biznesit e udhëheq dekani, ndërsa të gjitha vendimet në Fakultet i merr Këshilli mësimor - shkencor me shumicë votash, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjen me votim të fshehtë të dekanit dhe prodekanëve, komisionit të evaluimit etj. Studentët kanë përfaqësues të tyre në Këshillin mësimor - shkencor, të cilët zgjidhen nga Kuvendi Studentor i Fakultetit.

Tabela 1. Organogrami i Fakultetit të Administrimit të Biznesit

<i>Këshillimi Mësimor-Shkencor</i>	
<i>Dekani</i>	
<i>Prodekani për Arsim</i>	<i>Prodekani për Shkencë</i>
<i>Sekretari</i>	
<i>Mësimdhënësit</i>	<i>Studentët</i>
<i>Administrata</i>	<i>Shërbimi teknik</i>

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

4.1. Struktura e kuadrit mësimor

Në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë procesin mësimor në vitin akademik 2016/17 e kanë realizuar gjithsej 5 mësimdhënës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës.

Tabela 2. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë dhe struktura gjinore në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë.

NR.	THIRRJA	Statusi i punës		Gjinia	
		Të rregullt	Part time	M	F
1.	ORDINAR	2	/	2	/
2.	INORDINAR	1	/	1	/
3.	DOCENT	2	1	1	/
4.	ASISTENT	/	17	1 2	5
5.	DEMONSTRATOR	/	1	/	1

5. STRUKTURA E STUDENTËVE

5.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2016/2017, në drejtimin Administrim Biznesi ka pasur gjithsej 63 studentë, prej të cilëve 51 studentë me status të rregullt kurse 12 me korrespondencë. Prej tyre 33 kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 30 të gjinisë femërore.

Në vitin akademik 2017/2018, ka pasur gjithsej 43 studentë, prej të cilëve 31 kanë qenë me status të rregullt kurse 12 me korrespondencë. Prej tyre 21 kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 22 të gjinisë femërore.

Në vitin akademik 2018/2019 ka pasur gjithsej 59 studentë, prej të cilëve 43 studentë me status të rregullt kurse 16 me korrespondencë. Prej tyre 42 kanë qenë të gjinisë

7

mashkullore dhe 17 të gjinisë femërore.

Tabela 3. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Administrim Biznesi

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Me Korrespondencë	Numri i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	33	30	51	12	63	91
2017-2018	21	22	31	12	43	37
2018-2019	42	17	43	16	59	54

Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara, në vitin akademik 2016/2017, në drejtimin Administratë Publike ka pasur gjithsej 63 studentë, prej të cilëve 54 studentë me status të rregullt kurse 9 me korrespondencë. Prej tyre 35 kanë qenë të gjinisë mashkullore kurse 28 të gjinisë femërore. Në vitin akademik 2017/2018, ka pasur gjithsej 31 studentë, prej të cilëve 22 studentë me status të rregullt kurse 9 me korrespondencë. Prej tyre 13 kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 18 të gjinisë femërore. Në vitin akademik 2018/2019 ka pasur gjithsej 35 studentë, prej të cilëve 32 studentë me status të rregullt kurse 3 me korrespondencë. Prej tyre 13 kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 22 të gjinisë femërore.

Tabela 4. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Administratë Publike

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Me korrespondencë	Numri i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	35	28	5 4	9	63	6
2017-2018	13	18	2 2	9	31	1
2018-2019	13	22	3 2	3	35	2

5.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master)

Në vitin akademik 2016/17 në studimet e ciklit të dytë (studime master) janë regjistruar gjithsej 8 studentë vendas dhe 1 student shtetas i huaj prej të cilëve 5 në drejtimin Administratë Biznesi (3+2), 1 në drejtimin Administratë Publike (3+2), 2 studentë në drejtimin Administratë Biznesi (4+1) dhe një shtetasi huaj në drejtimin Administratë Biznesi

(4+1).

Tabela 5. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2016-17

Nr. Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	ADMINISTRATË BIZNESI	5	/	5
2	3+2	ADMINISTRATË PUBLIKE	1	/	1
3	4+1	ADMINISTRATË BIZNESI	2	1	3
Gjithsej			8	1	9

Në vitin akademik 2017/18 në studimet e ciklit të dytë master janë regjistruar gjithsej 4 studentë vendas dhe 1 student shtetas i huaj, prej te cilëve 3 në drejtimin Administratë Biznesi (3+2), 1 student në drejtimin Administratë Biznesi (4+1) dhe një student i huaj në drejtimin Administratë Biznesi (4+1).

Tabela 6. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2017-18

Nr. Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	ADMINISTRATË BIZNESI	3	/	3
2	3+2	ADMINISTRATË PUBLIKE	/	/	/
3	4+1	ADMINISTRATË BIZNESI	1	1	2
Gjithsej			4	1	5

Në vitin akademik 2018/19 në studimet e ciklit të dytë master janë regjistruar gjithsej 6 studentë vendas, 3 në drejtimin Administratë Biznesi (3+2), 3 studentë në drejtimin Administratë Biznesi (4+1) dhe një student i huaj në drejtimin Administratë Biznesi (4+1).

Tabela 7. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2018-19

Nr. Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	ADMINISTRATË BIZNESI	3	/	3

9

2	3+2	ADMINISTRATË PUBLIKE	/	/	/
3	4+1	ADMINISTRATË BIZNESI	3	1	4
Gjithsej			6	1	7

6. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve hulumtuese, Fakulteti i Administrimit të Biznesit së bashku me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës organizon konferenca shkencore me bord editorial nga pedagogë vendas dhe pedagogë me të cilët Universiteti ynë ka bashkëpunim të ndërsjellë, si dhe boton Revistën shkencore “Economic Vision” me bord nga pedagogë vendas dhe të huaj. Vijueshmëria aktive si pjesëmarrës dhe organizatorë të konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta të stafit ka rezultuar me prezantime të suksesshme të arritjeve shkencore dhe me bashkëpunime të ardhshme në hulumtime shkencore mes pedagogëve të universitetit tonë dhe universiteteve të tjera. Po ashtu organizimet e konferencave kanë mundësuar shkëmbim të stafit të Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe fakulteteve të tjera sidomos për ciklet e studimit të nivelit të parë dhe të dytë.


Më 02.12.2016 Fakulteti i Administrimit të Biznesit së bashku me Fakultetin Ekonomik ka organizuar një sërë konferencash shkencore, edhe atë: Konferencën IV Shkencore me temë “The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkan”; më 01.12.2017, Konferencën V Shkencore me temë “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”; më 19-20.11.2018, Konferencën VI Shkencore me temë “Economic Development as a Precondition for EU Integration” dhe më 13-15.11.2019, Konferencën VII Shkencore me temë “Contemporary Economic Trends”. Në të gjitha konferencat e lartpërmendura referuan një numër i madh profesorësh, studiuesish nga vendi, rajoni dhe më gjerë.

Tabela 8. Revistat shkencore të publikuara nga Fakulteti i Administrimit të Biznesit gjatë viteve akademike: 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 (ISSN: 1857-9566 Print; ISSN: 2545-4544 (Online))

TITULLI I REVISTËS	VOLUMI, VITI
ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.4.No.7&8 pp.1-205) 2017
ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.5.No.9&10 pp.1-181) 2018
ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.6.No.11&12 pp. 1-200) 2019

Në Revistën shkencore “Economic Vision” që botohen në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe Fakultetit Ekonomik, në vitin 2017 u botua volumi IV dhe numri 7-8, me 21 punime shkencore, në vitin 2018 volumi V dhe numri 9-10, me 20 punime shkencore dhe në vitin 2019 u botua volumi VI dhe numri 11-12, me 21 punime shkencore.

Grafiku 1. Punimet e botuara në Rrevistën shkencore “Economic Vision” sipas autorëve



Në botimin e vitit 2017 të Revistës shkencore “Economic Vision” punimet e tyre kanë botuar 15 autorë vendas dhe 6 autorë të huaj; në botimin e vitit 2018 punimet e tyre i kanë botuar 17 autorë vendas dhe 3 autorë të huaj dhe në botimin e vitit 2019 punimet e tyre i kanë botuar 18 autorë vendas dhe tre autorë të huaj.

Në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/2019 stafi akademik i Fakultetit të Administrimit të Biznesit ka botuar rreth 35 punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

7. REALIZIMI I ORËS MËSIMORE NË KUADËR TË FAKULTETIT

7.1. Anketimi i studentëve

Gjate vitit 2016 në programet studimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit është realizuar evaluim i orëve mësimore, gjatë të cilit proces nga ana e studentëve janë plotësuar gjithsej 120 pyetësorë. Rreth 92 % e përgjigjeve në Fakultetin e Administrimit të Biznesit tregojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 85 % se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Përqindja më e madhe e studentëve që deklarojnë se ligjëratat fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit të paraparë janë në programin studimor Administrim Biznesi dhe në Administratë Publike.

Rreth 76% e studentëve në Fakultetin e Administrimit të Biznesit deklarojnë se gjatë ligjëratës kanë bërë pauzë 10 deri 15 minuta.

Për realizimin e orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin e Administrimit të Biznesit përdoren mjete të ndryshme për prezantim. Studentët deklarojnë (rreth 50%) se gjatë ligjëratës mësimdhënësit kanë përdorur prezantime Power Point, kurse rreth 30% e studentëve deklarojnë se përdoret tekst në dërrasë dhe rreth 10% deklarojnë se gjatë ligjërimit mësimdhënësit nuk përdorin asnjë mjet për të realizuar ligjëratën. Përqindja më e madhe e studentëve të cilët deklarojnë se mësimdhënësit kanë përdorur prezantim Power Point me përqindje më të madhe (rreth 55%) janë studentët e programit studimor Administrim Biznesi dhe rreth 45% janë studentët e programit studimor Administratë Publike.

Realizimi i ligjëratave

Studentët kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës mësimore në të gjitha pyetjet. Edhe atë, vlerësim më pozitiv kanë dhënë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit. Që të tria karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si dominante pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit (tabela 8).

Tabela 9. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

	Tema në përputhshmëri me ligjëratat	Ligjërata të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
Administrim Biznesi	4.12 (70)	4.31 (70)	4.43 (70)	4.31 (70)
Administratë Publike	3.84 (50)	4.36 (50)	4.57 (50)	4.46 (50)

Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve në të cilët janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=4.12 dhe M=3.84), “mësimdhënësit kanë pyetur për paqartësi” (M=4.31 dhe M=4.36), në indikatorin “ligjërues i sigurt gjatë orës” përgjigjet janë (M=4.43 dhe M=4.57), ndërsa në përgjigjen “ligjërues bindës” (M=4.31 dhe M=4.46) dhe “studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për të përgatitur temën në temën konkrete” janë përgjigjur me (M=4.43), ndërsa vlerësimi nën mesatar është për indikatorin “orientim i mjaftueshëm për burime shtesë” (M=2.75%), si dhe “lidhshmëria e përmbajtjeve të prezantuara me përmbajtje të lëndëve tjera” (M=2.64%).

8. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Fakulteti i Administrimit të Biznesit disponon me një sipërfaqe prej 2051 m². Kjo hapësirë përfshin amfiteatrot me një sipërfaqe prej 700 m², në të cilët mbahen ligjëratat dhe ushtrimet. Klasat në të cilat zhvillohen ligjëratat dhe ushtrimet kanë një sipërfaqe prej 747 m². Krahas hapësirave të përmendura, Fakulteti i Administrimit të Biznesit disponon edhe me 18 kabinete me sipërfaqe 262 m², hapësirë administrative me sipërfaqe 257 m² dhe klasa kompjuterike me sipërfaqe 85 m².

Në të ardhmen është planifikuar të ndërmerren masa dhe aktivitete të tjera për sigurimin e kushteve optimale dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e veprimtarisë mësimore -shkencore dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë së këtij institucioni.

Tabela 10. Hapësirat dhe pajisjet në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit për realizim të procesit mësimor-shkencor

	Hapësirat	Njësitë	m²
1	Salla	12	747 m ²
2	Amfiteatro	7	700m ²
3	Kabinete	18	262m ²
4	Hapësira administrative	8	257 m ²
5	Klasa kompjuterike	1	85m ²
Gjithsej			2051 m²
	Pajisjet	Njësitë	
1	Cisco 16 port 10/100 Switch	2	
2	ADSL Router/4 port switch	1	
3	Wireless router/4 port switch	1	
4	Switch 10/100	7	
5	Patch panel	1	
6	Rack	1	
7	Modem telelabs 512	1	
8	Laptopë	5	

9	PC desktopë	30
10	Printerë	5
11	Smart board	1
12	Projektorë	6
13	Fax	1
14	Pajisje elektronike për evidencë të të punësuarve	1
15	License Win Xp pro Laptop	5
Gjithsej		68

9. SWOT ANALIZA

SWOT analiza si një model themelor i planifikimit strategjik në kuadër të Fakultetit të Administrimit të biznesit është përdorur si një kornizë për identifikimin dhe analizën e faktorëve të brendshëm (fuqive dhe dobësive) dhe faktorëve të jashtëm (mundësive dhe kërcënimeve) që ndikojnë në funksionimin e suksesshëm të tij.

Në bazë të kësaj analize në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit mund të veçohen fuqitë/përparësitë që e karakterizojnë funksionimin e suksesshëm të tij, ku përfshihen:

- Statistika të besueshme në dispozicion;
- Procedura të qarta të regjistrimit të semestrave;
- Zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të Fakultetit;
- Ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore;
- Infrastrukturë të përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese;
- Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative;
- Siguri, bindshmëri dhe qartësi e mësimdhënësve gjatë ligjërimit,
- Avancim i vazhdueshëm i stafit akademik.

Tabela 11. SWOT analiza në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit

FUQITË	MUNDËSITË
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Statistika të besueshme në dispozicion; ✓ Procedura të qarta të regjistrimit të semestrave; ✓ Zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të Fakultetit; ✓ Ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore; ✓ Infrastrukturë të përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese; ✓ Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore .kualitative ✓ Siguria, bindshmëria dhe qartësia e mësimit gjatë ligjërimit ✓ Avancimi i vazhdueshëm i stafit akademik 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Lidhjen e botës akademike me biznesin; ✓ Mundësi mobiliteti të stafit dhe studentëve; ✓ Mundësi të lidhjes së teorisë me praktikën; ✓ Bashkëpunime; ✓ Memorandume.
DOBËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Financimi; ✓ Numër i pamjaftueshëm i stafit akademik; ✓ Teknologjia informative 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Oferta e kuotave jo çdo vit përputhet me kërkesën; ✓ Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësim; ✓ Konkurrencë jolojale, që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë

10. KONKLUZIONI

Realizimi i procesit të evaluimit të Fakultetit të Administrimit të Biznesit paraqet një çështje mjaft të rëndësishme, e cila përfshin dy segmente kryesore: zbatimin e dispozitave të Ligjit të arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat dispozita obligojnë në realizimin e të njëjtit dhe njohja me gjendjen reale në të cilën zhvillohet procesi mësimor - shkencor.

Sigurisht se të dhënat përkatëse do të jenë udhërrëfyese për veprimtarinë tonë në vazhdimësi, për përcaktimin e politikave zhvillimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete në sferën mësimore - shkencore dhe ndërmarrja e masave konkrete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe avancimit të veprimtarisë administrative në Fakultet.

Gjatë përgatitjes së raportit kemi hasur në bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme nga menaxhmenti, pedagogët dhe administrata e Fakultetit të Administrimit të Biznesit që flet për një klimë kooperuese dhe një nivel të lartë komunikimi akademik në të gjitha nivelet në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit.

Komisioni për vetevaluim në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit

- Doc. Dr. Llokman Hebibi - kryetar
- Prof. Dr. Naser Raimi - anëtar
- Prof. Dr. Nehat Ramadani - anëtar
- PhD Cand Armend Asllani - anëtar
- Andi Beqiri - student
- Sara Osmani - studente